



Informacione për prindërit – Përkrahja e talenteve

Të dashur prindër

Fëmijët dhe të rinjtë me talente të theksuar duhet që të mund ta zgjerojnë edhe më tej talentin e tyre. Kjo shpesh paraqet për prindërit dhe mësuesit një sfidë të veçantë. Në vijim do të gjeni informacione mbi temën „shumë të talentuarit”, për njohjen si dhe përkrahjen e fëmijëve dhe të rinjve shumë të talentuar, si në shtëpi dhe në shkollë.

Aftësitë e veçanta/shumë të talentuarit

Anna llogarit që në klasën e dytë duke luajtur deri në 1000. Rafael di me dhjetë vjet disa vjersha përmendsh dhe shkruan tregime të gjata. Anna dhe Rafael janë dy shembuj për fëmijët, që bien në sy nëpërmjet talenteve të veçantë dhe rezultateve të jashtëzakonshme, për sa u përket gjuhëve, matematikës, teknikës, muzikës, artit, marrëdhënieve sociale ose sportit.

Për një talent të veçantë flitet atëherë kur nxënësja ose nxënësi në një ose më tepër fusha janë dukshëm më para se sa moshatarët e tyre. Nëse ky kapërcim është i shfaqur në një masë të theksuar, atëherë mund të flitet për aftësi të theksuar ose për shumë të talentuar. Sipas të dhënave statistikore dhe definicionit të talentit dhe inteligjencës këtu bëjnë pjesë rreth 1% deri 3% e nxënësve.

Tek shumë fëmijë dhe të rinj të talentuar, potenciali i zhvillimit dhe i zgjerimit të talentit të tyre ecën në mënyre harmonike. Mësimi në klasën e rregullt mund ti mbulojë nevojat e tyre, ngaqë mësuesit merren me situatën e tyre speciale dhe shumë të talentuarit gjejnë gjithashtu vet rrugë dhe zgjidhje. Mos ngarkesa e duhur ose problemet në fushën sociale ose emocionale mund krijojnë tek nxënëset dhe nxënësit shumë të talentuar nevoja të veçanta pedagogjike. Në këtë rast është e nevojshme një përkrahje shtesë nga prindërit dhe në shkollë në kuadër të «përkrahjes së talenteve».

Dallimi i fëmijëve dhe të rinjve shumë të talentuar

Fëmijët dhe të rinjtë me talent të theksuar shpesh tërheqin vëmendjen që në shpi dhe më vonë edhe në shkollë, nëpërmjet rezultatit dhe sjelljes së tyre. Talentet nuk janë gjithmonë lehtë për tu dalluar, ngaqë ata jo detyrimisht kanë në mënyrë konstante rezultate të larta. Anasjelltas rezultatet mbi mesataren nuk mund të shpjegohen medoemos me një talent të theksuar. Tek nxënëset dhe nxënësit me gjermanishten si gjuhë jo të parë (gjuhë jo amtare),

vajzat, nxënëset dhe nxënësit me talent të theksuar, zhvillimi i të cilëve ka pengesa dhe potenciali i tyre nuk mund të vihet në punë, në këto raste është e vështirë që të dallohet talenti i tyre.

Anketimet vrojtuese dhe listat me shenjat tipike për shumë të talentuarit, mund ti ndihmojnë prindërit dhe mësuesit që ti kushtojnë vëmendje shumë të talentuarve (shiko broshurën «Talentet dhe përkrahja e talenteve», faqe. 16). Ata japin të dhëna, por ata në asnjë mënyrë nuk i zëvendësojnë bisedat me mësuesit dhe sqarimet e personave të kualifikuar. Veçanërisht nëse masat përkrahëse qëndrojnë për diskutim atëherë sipas rregullit kërkohet një vlerësim i plotë nëpërmjet shërbimit psikologjik shkollor.

Çfarë mund të bëj shkolla?

Përkrahja shkollore e nxënësve dhe nxënësve shumë të talentuar duhet të mundësoj stimulime në një nivel të lartë, ta zgjeroj dijen dhe aftësitë në të gjitha fushat e mundshme speciale dhe të përkrah zhvillimin personal harmonik në përgjithësi. Format individuale mësimore në klasën e rregullt, në rast nevojë me një përkrahje të veçantë nëpërmjet mësuesit përkrahës mund ta garantojnë këtë në të shumtën e rasteve. Lënda mësimore për shembull mund të komprimohet dhe të mësohet në një kohë të shkurtër (Compacting). Kështu mbetet kohë për një zgjerim dhe thellim të qëllimeve dhe përmbajtjeve mësimore (Enrichment), për shembull me projekte individuale. Masat e mëtejshme, të cilat duhet të shoqërohen dhe të planifikohen me kujdes janë: shkollimi i hershëm në kopshtin për fëmijë ose klasa e parë e shkollës fillore, kapërcimi i një klase ose frekuentimi i disa lëndëve të veçanta në klasat e larta.

Si dhe në ç'masë, pedagogët shërues marrin pjesë në përkrahjen e nxënësve shumë të talentuar, qëndron në përgjegjësinë e shkollës. Lokalitetet shkollore vendosin vetë për këtë, në qoftë se ata, pranë mbështetjes dhe përkrahjes brenda klasës së rregullt, duhet të ofrojnë oferta shtesë (p. sh. kurse, mentor nëpërmjet ekspertëve të jashtëm shkollor). Informacione më të hollësishme në lidhje me këta oferta mund ti merrni tek drejtorja e shkollës.

Nëse shfaqen vështirësi në klasën e rregullt në lidhje me ndonjë talent të theksuar, atëherë mësuesit dhe prindërit kërkojnë së bashku një zgjidhje. Në rast nevojë vendosen në kuadër të bisedës shkollore (Schulische Standortgespräch) qëllime individuale dhe përkrahëse mësimore si dhe zbatimi dhe verifikimi i masave përkrahëse.

Cfarë mund të bëjnë prindërit?

Nëpërmjet përkrahjes dhe shoqërimit të tyre në çështjet shkollore dhe në krijimin e kohës së lirë, jepni kontribut tuaj që fëmija juaj të mund ta zgjerojë dhe shfrytëzojë potencialin e tij. Si prindër i një fëmije me talent të theksuar, jeni vënë ndoshta shpesh vet para pretendimeve të ndryshme. Për shembull ju keni pyetur veten: a është i duhur një edukim i veçantë? Si mund ta përkrahim në fëmijën tonë më së miri? Si mund të sillemi në familje me këtë situatë të veçantë? Tek këta ose pyetjet e tjera ju rekomandohet një konsultim nëpërmjet të një personi të specializuar (shiko poshtë konsultim/literaturë).

Në plan të parë qëndrojnë interesat dhe prirjet e fëmijës tuaj. Kini kujdes që ju dhe fëmija juaj të mos ngarkoheni dhe të qëndroni nën presionin e rezultateve të larta. Ndhmoni fëmijën tuaj që ti njoh aftësitë dhe dobësitë e tij. Përkraheni atë që të dijë të sillet mirë me talentin e tij të theksuar.

Në qoftë se keni ndonjë lutje të veçantë për shkollën ose nëse shfaqen probleme, atëherë kërkoni me kohë një bisedë me mësuesin e klasës. Në radhë të dytë, person komunikimi për ju është drejtorja e shkollës.

Ekspertizat e personave të specializuar privat mund të përfshihen në planin përkrahës. Duke i pas parasysh vendimet e rëndësishme shkollore dhe masat përkrahëse të cilat janë të lidhura me shpenzime shtesë, rekomandohet rruga nëpërmjet shërbimit psikologjiko shkollor. Sepse është me rëndësi, që fëmija juaj të marrë pjesë në vendime në mënyrë që ai ta forcojë përgjegjësinë vetjake.

Konsultim dhe informacione

Shoqata prindërore për fëmijët e talentuar (EHK – Elternverein für hochbegabte Kinder): www.ehk.ch

Fondacioni për fëmijët e talentuar (Stiftung für hochbegabte Kinder): www.hochbegabt.ch

Në lidhje shkollore lokale (Im lokalen, schulischen Zusammenhang): Klassenlehrperson, Schulleitung, Schulpsychologischer Dienst (www.vsa.zh.ch → Gesundheit und Prävention → Schulpsychologische Dienste)

Zyra e shkollës fillore në Cyrih: www.vsa.zh.ch → Schulbetrieb und Unterricht → Begabungs- und Begabtenförderung

Literaturë

- Broshüre «Begabungs- und Begabtenförderung» aus Ordner 3, Umsetzung Volksschulgesetz, Angebote für Schülerinnen und Schüler mit besonderen pädagogischen Bedürfnissen
www.vsa.zh.ch → Schulbetrieb und Unterricht → Begabungs- und Begabtenförderung
(Broshurë «Talentet dhe përkrahja e talenteve» nga dosja 3 realizimi i ligjit të shkollës fillore, oferta për nxënëse dhe nxënës me nevoja të veçanta pedagogjike)
- Hochbegabte Kinder – ihre Eltern, ihre Lehrer. Ein Ratgeber Webb, J.T., Meckstroth, E.A., Tolan, S.S., Zimet, N.D., Preckel, F. / Bern, 2002. Verlag Hans Huber
- Unser Kind ist hochbegabt. Ein Leitfaden für Eltern und Lehrer Mönks, F.J., Ypenburg, I. / München und Basel, 2000. Ernst Reinhardt Verlag
- Mythos Begabung – Vom Potenzial zum Erfolg Stedtnitz, U. / Bern, 2008: Verlag Hans Huber